

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump foli për Irlandën e Bashkuar, përgjigjet Britania e Madhe - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/trump-foli-per-ir-landen-e-bashkuar-pergjigjet-britania-e-madhe/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 13:21:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 12:44:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c442ec138418db77c775b4a3bf3b5d5a1c81f9c1ab313ddd345109785dadf869
TEKSTI	c6bdf4a4e9eba4a9b2251afc4f5a1d6889c23a7e4bda3e33aaf0b2dea2549a13
PAMJA	c46949f423ddcc82bd92d9eaa549b939a6e361b63853a91ae0c44369f1953579

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2be98026567f69545c05026b71fa9900015a12de33355c3c3dbbb46b6763603b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2b81d04eb2d7a0b950a06cfe4d4e25424c0bc0e9ce056d5f2521565ca26b7d7f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2be98026567f69545c05026b71fa9900015a12de33355c3c3dbbb46b6763603b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Edi Rama Inteligjenca Artificiale Kuvendi i Kosovës Donald Trump

BOTA

Trump foli për Irlandën e Bashkuar, përgjigjet Britania e Madhe

13 Shtator 2026 | 14:44

Qeveria britanike ka reaguar pas deklaratës së presidentit amerikan Donald Trump se do të "donte" të shihte një Irlandë të bashkuar, duke bërë të qartë se pozicioni i Londrës për statusin e Irlandës së Veriut nuk ka ndryshuar.

Zyra e kryeministrit britanik Andy Burnham theksoi se aktualisht nuk ka prova që tregojnë se shumica e popullsisë së Irlandës së Veriut dëshiron largimin nga Mbretëria e Bashkuar dhe bashkimin me Republikën e Irlandës.

Për këtë arsye, sipas Londrës, nuk ekzistojnë kushtet për organizimin e një referendumi për ndryshimin e statusit kushtetues të Irlandës së Veriut.

Reagimi erdhi pasi Trump, gjatë vizitës së tij në Irlandë, deklaroi se do të donte të shihte bashkimin e ishullit.

"Do të doja ta shihja të bashkuar", tha Trump, duke e cilësuar një Irlandë të bashkuar si "një gjë fantastike".

Presidenti amerikan sugjeroi gjithashtu se bashkimi mund të ndodhë në të ardhmen, por pranoi se Mbretëria e Bashkuar ka një rol thelbësor në këtë proces.

Komentet e Trump prekën menjëherë një nga çështjet më të ndjeshme politike dhe historike mes Britanisë dhe Irlandës.

Sipas Marrëveshjes së së Premtes së Mirë të vitit 1998, statusi kushtetues i Irlandës së Veriut mbështetet në parimin e pëlqimit. Irlanda e Veriut mbetet pjesë e Mbretërisë së Bashkuar për aq kohë sa ky është vullneti i shumicës së popullsisë së saj.

Marrëveshja parashikon gjithashtu mundësinë e një referendumi, të njohur si "border poll", nëse qeveria britanike arrin në përfundimin se ekziston mundësia që shumica të votojë për bashkimin me Republikën e Irlandës.

Por qeveria britanike këmbëngul se ky moment nuk ka ardhur.

Burnham ka deklaruar më parë se nuk sheh aktualisht prova të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se shumica në Irlandën e Veriut dëshiron ndryshimin e statusit kushtetues.

Deklaratat e Trump janë veçanërisht të pazakonta për një president amerikan. Uashingtoni ka luajtur historikisht një rol të rëndësishëm në procesin e paqes në Irlandën e Veriut, por presidentët amerikanë zakonisht kanë shmangur mbështetjen e drejtpërdrejtë për bashkimin ose për ruajtjen e status quo-së.

LAJMI I FUNDIT

15:07 Kurti për procesin në Hagë: Serbia kreu gjenocid ndaj shqiptarëve, asnjë gjykatë nuk e njollos luftën e UÇK-së

14:22 Debate të forta për "Territorialet", tensione mes Ramës dhe krybashkiakut të Pollicanit! Përfaqësuesit largohen nga takimi

SHPËRNDARJE
ARTIKULLIN
Një ish-oficer i Stasi-t, një ish-aktor filmash për të rritur dhe persona nën hetim për lidhje neo-naziste! Kush janë deputetët e rinj të AfD-së

13:55 Kuvendi thërret seancë në orën 14:00, në rend dite zgjedhja e Qeverisë

13:27 Droni rus godet trenin me pasagjerë që udhëtonte nga Kiev për në Varshavë

13:17 Albulena Haxhiu mandaton Albin Kurtin për formimin e Qeverisë së Kosovës

TESTIM

Ndërhyrja e Trump e rikthen kështu çështjen e një Irlandë të bashkuar në qendër të debatit politik, ndërsa Londra përgjigjet se çdo ndryshim mund të vijë vetëm përmes vullnetit demokratik të qytetarëve të Irlandës së Veriut.

Shiko në:

Lajme të sugjeruara

BOTA
Një ish-oficer i Stasi-t, një ish-aktor filmash për të rritur dhe persona nën hetim për lidhje neo-naziste! Kush janë deputetët e rinj të AfD-së
Pas fitores historike të partisë së ekstremist të djathtë, AfD në landin e Saksoni-Anhalt, vëmendja në Gjermani është zhvendosur te profili i disa prej deputetëve...
14:14 | 13/09/2026

BOTA
Droni rus godet trenin me pasagjerë që udhëtonte nga Kievi për në Varshavë
Dronët rusë kanë sulmuar të dielën në mëngjes një zonë pranë pikës së kalimit kufitar mes Ukrainës dhe Polonisë, duke goditur edhe një tren pasagjerësh...
13:27 | 13/09/2026

BOTA
Rusia sulmon Ukrainën me 453 dronë
Rusia ka lëshuar 453 dronë në drejtim të Ukrainës gjatë sulmeve të natës, sipas Forcave të Armatosura të Ukrainës. Nga këta, 409 u neutralizuan, ndërsa 13 objekte u goditën. Në qytetin e Stryit,...
12:07 | 13/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: